



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 1364/4 Prot.

Datë: 11.09.2020

[Handwritten signature]

11/09/20
12:44

Morre dhe për
Këshillin e Etikës

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 08. 09. 2020

VENDIM

Nr. 81, datë 08. 09. 2020

MBI NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 62, DATË 11. 02. 2020 "PËR KRITERET DHE STANDARTET PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJATURË TË DISERTACIONEVE TË PËRDORURA PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE NË UV"

Në mbështetje të nenit 37, nenit 38, nenit 44 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 99, datë 05. 02. 2020 "Për disa ndryshime në VKM nr. 777, datë 26. 12. 2018 të Këshillit të Ministrave, "Për kontrollin antiplagjaturë të disertacioneve të përdorura për fitimin e gradës shkencore", të Urdhrit nr. 8, datë 14. 01. 2020 të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", të vendimit të SA nr. 59, datë 11. 02. 2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë" dhe Rregullores së etikës së kërkimit dhe publikimit shkencor në UV, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08. 09. 2020

VENDOSI:

1. Të miratojë si një nen të veçantë në Rregulloren e etikës së kërkimit shkencor dhe publikimit shkencor në UV se Këshilli i Etikës së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë shqyrton dokumentacionin për kontrollin antiplagjaturë të disertacioneve të përdorura për fitimin e gradës shkencore vetëm për ato tituj/ grada të fituara dhe që do të fitohen në vazhdimësi vetëm në UV.
2. Ngarkohet Këshilli i Etikës i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

